

STATUTI I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

AGROTEC-2

Ne Gjirokaster, sot me date 20/01/2012 (njezet janar dymije e dymbedhete) me vullnetin tim te lire dhe bazuar ne ligjin 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare , une i nenshkruari:

-Kastriot Çarçani i biri i Avniut i dtl. 15/11/1964 banues ne Gjirokaster mbajtes i kartes me Nr.028372402.

Vendosa :

NENI 1

Te redaktoj Statutin e Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin ” AGROTEC-2 “ shoqeria eshte e formes ” Sh.p.k.

NENI 2

Objekti i veprimtarise te shoqerise do te jete :

- Tregti e pergjithshme, import-eksport te makinerive bujqesore, aggregateve dhe pjeseve te tyre te kembimit.

NENI 3

Afati i shoqerise :

Shoqeria do ta ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe te pa caktuar kohore

Por ky afat mund te ndryshoje me vullnetin e lire te ortakeve

NENI 4

Selia e shoqerise :

Selia e shoqerise do te jete ne: GJIROKASTER L. 18 SHTATORI

NENI 5

Kapitali i shoqerise :

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100.000 leke (njqind mije leke).

I ndare ne 100 kuota me nga 1000 leke (njemije leke) secila kuote.

Kapitali i shoqerise do te zoterohet ne masen :

- **Kastriot Çarçani 100%** te kapitalit te shoqerise te barabarte me 1000 (nje mije) leke.

Shoqeria mund ta zmadhoje ose ta zvogeloje kapitalin e saj .

NENI 6

Pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara nga ortaket jane lirisht te transmetueshme nepermjet :

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) dhurimit
- c) Trashegimise
- ç) Shitjes

Ortaket e shoqerise kane te drejten e parablerjes se kuotave te ofruara per shitje .

Çdo mos marreveshje ndermjet ortakeve zgjidhet nepermjet Gjykates .

Asambleja e ortakeve miraton transferimin e tyre .

NENI 7

Fitimi i realizuar nga veprimtaria e shoqerise u takon ortakve te shoqerise ne raport me kontributin e e tyre ne krijimin e shoqerise .

Fitimi i deklaruar ne pasqyrat financiare mund te shperndahet vetem nese shoqeria ka likuide te mjaftueshme qe garantojne shlyerjen e detyrimeve .

Shoqeria mund te kerkoje kthimin e dividenteve te shperndare tek ortaket e saj ne rast se shperndarja eshte bere ne kundersizim me kete dispozite .

NENI 8

Administrimi :

Organi me i larte i shoqerise eshte asambleja e pergjitheshme e ortakeve .
Asambleja e ortakeve thirret nga ortaket ose administrator i shoqerise .

Njoftimi per mbledhjen e asamlese se ortakeve behet me shkrese zyrtare dhe u dergohet ortakeve te pakten 10 dite perpara dates se mbledhjes .

Administratori drejton mbledhjen e asamlese se ortakeve .

Ortaket mund te perfaqesohet gjate mungeses se tyre nga nje ortak tjetër ose nje person i autorizuar .

Autorizimi eshte i vlefshem vetem per nje mbledhje

Asambleja e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve si me poshte :

Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise .

Ndryshimet e statutit te shoqerise I cili behet me $\frac{3}{4}$ e kuotave te kapitalit te shoqerise .

Emerimin dhe shkarkimin e administratorit .

Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel .

Pregatitjes se pasqyrave financiare .

Futjen e ortakeve te rinj ne shoqeri .

Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise.

Zmadhimin ose zvogelimin e aktivitetit te shoqerise .

Riorganizimin , bashkimin , ndarjen apo prishjen e shoqerise .

Krijimin ose mbylljen e filialeve te tjera te shoqerise .

Vendimet e mbledhjes se asamlese se ortakeve pasqyrohen ne nje rregjister te vecante

NENI 9

Administratori :

Administrator i shoqerise do te jete **Kastriot Çarçani.**

Afati administratorit do te jete 5 (pese) vjeçare me te drejte riperteritje.
Afati i administratorit mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve .

NENI 10

Administratori i shoqerise ka kopetence dhe detyrohet te kryeje veprimet e percaktuara kryesisht ne nenin 95 te ligjit 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” .

Administrator mund te shkarkohet me vendim te samblese se ortakeve .

Administratoret permbushin detyrimet qe u linden nga neni 98 te ligjit 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” .

NENI 11

Per arritjen e qellimeve te veta shoqeria mund te punesoje punonjes te tjere te ndryshem , duke respektuar legjislacionin ne fuqi .

NENI 12

Ortaku mund te perjashtohet nga shoqeria me vendim te gjykates per arsyet e permendura ne nenin 102 te ligjit 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” .

Shoqeria rezervon te drejten per te kerkuar shperblimin e demit te ardhuar nga veprimet e ortakut qe cuan ne perjashtimin e tij .

NENI 13

Shoqeria priset :

Ne perfundim te afatit .


Eshte vendosur me unanimitet nga asambleja e pergjitheshme e ortakeve
Me hapjen e procedurave te likujdimit .
Me vendim te Gjykates

NENI 14

Fitimi qe do te rezultoje nga veprimtaria e shoqerise i takon ortakeve te saj .
shoqeria nuk pergjigjet per humbjen e ortakeve te saj jashte veprimtarise se
shoqerise . Mosmarreveshjet qe mund te lindin mes paleve brenda dhe jashte
shoqerise , me persona fizike e juridike zgjidhen nga Gjykata kopetente Shqiptare.

ORTAKU THEMELUES

Kastriot Çarçani


ACROTEK - 2 sh.p.k
IMPORT - EXPORT - SHPËRNERI BUJQËSORE.
NIPT: K 62617819
GJIROKASTËR ALBANIA
TEL: 0684004601 - 0684091771